



**NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.**

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, neni 21 paragrafit 4, Ligji për Shoqëritë Tregtare, Ligjin Nr.03/L-212 i Punës, Statutit Nr.08/868, të datës 30.05.2022, të NPH “Ibër Lepenc”, si dhe Kodin e Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2025 miratoi këtë:

**RREGULLORE NR. 04/2025 PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM TË
PUNËTORËVE TË N.P.H. “IBËR-LEPENC” SH.A.**

PRISHTINË, QERSHOR 2025

Neni 1

Qellimi

1.1. Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat dhe rregullat e brendshme, përfshirë edhe afatet kohore për trajtimin e çështjes së pensionimit të parakohshëm të punëtorëve të NH "Ibër Lepenc" Sh.A.

Neni 2

Fushëveprimi

2.1. Të gjitha dispozitat e kësaj Rregullore aplikohen me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të pensionimit të parakohshëm të punëtorëve të NH "Ibër Lepenc" Sh.A.

Neni 3

Rastet për pensionim të parakohshëm

3.1. Punëtorët e NH "Ibër Lepenc" Sh.A., sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore, me kërkesë me shkrim mund të kërkojnë pensionimin e parakohshëm jo më shumë se 2 (dy) vite para afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 67, paragrafi 1, pika 1.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

3.2. Punonjësi me vullnetin e tij/saj të shprehur me shkrim mund të përfitojë nga skema e pensionimit të parakohshëm pas aplikimit të gjitha procedurave të shqyrtimit të kërkesës, siç janë të përcaktuara në nenin 4.

Neni 4

Procedura për pensionim të parakohshëm

4.1. Çdo punëtor i NH "Ibër Lepenc" Sh.A. që plotëson kushtet sipas dispozitave të nenit 3 të kësaj rregulloreje, me kërkesë me shkrim mund të kërkojë pensionimin e parakohshëm.

4.2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni i dërgohet Departamentit të Shërbimeve të Përbashkëta, përkatësisht Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes, të cilët brenda afatit 3 ditor do të verifikojë nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson apo jo kushtet e parashikuara për pensionim të parakohshëm.

4.3. Burimet Njerëzore japid opinionin e tyre nëse kërkesa është në pajtim me rregulloren dhe ia dërgojnë kërkesën eprorit të punonjësit për të dhënë pëlqimin apo për ta refuzuar kërkesën nëse nuk është në pajtim me rregulloren.

4.4. Eprori përkatës e shqyrton kërkesën, duke marrë parasysh rëndësinë e njësisë përkatëse organizative, mundësinë e zëvendësimit adekuat të kryerjes së punës që aktualisht realizohet nga punonjësi i njësisë organizative të Ndërmarrjes, si dhe planifikimin e personelit për detyrat e ardhshme të punonjësve të Ndërmarrjes.

4.5. Pas shqyrtimit të kërkesës sipas kritereve të lartpërmendura dhe kritereve të tjera në favor të politikës zhvillimore të Ndërmarrjes, eprori përkatës i punonjësit që ka paraqitur kërkesën për pensionim të parakohshëm jep mendimin e tij brenda një afati prej 7 ditësh, të cilin ia dërgon Burimeve Njerëzore.

4.6. Pas marrjes së mendimit nga eprori përkatës i punonjësit, Burimet Njerëzore e kompletojnë lëndën e punonjësit që kërkon pensionim të parakohshëm dhe ia dërgojnë Kryeshefi Ekzekutiv të Ndërmarrjes Brenda afatit tre (3) ditor.

4.7. Kryeshefi Ekzekutiv, sipas rekomandimeve nga Burimet Njerëzore dhe Eprori përkatës i punonjësit, e shqyrton kërkesën dhe merr vendim përfundimtar në afat prej 5 ditësh duke marrë parasysh analizën e bërë nga Departamenti Financiar sipas nenit 7 prg.7.1 të kësaj rregullore.

Neni 5

Periudha e pensionimit të parakohshëm

5.1. Pensionimi i parakohshëm nuk mund të zgjasë më shumë se 2 (dy) vite para kohës së pensionimit të rregullt sipas Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të përcaktuar në nenin 67, paragrafi 1, pika 1.4.

Neni 6

Vlera e kompensimit financiar

6.1. Kompensimi financiar në "Pensionimi i Parakohshëm" zgjat maksimalisht 2 (dy) vite përveç nëse kontrata me punonjësin ndërpritet sipas fuqisë ligjore të paraparë në nenin 67 të Ligjit të Punës.

6.2. Kompensimi financiar (paga) i nënshtrohet të gjitha ligjeve që rregullojnë sferën e tatimeve dhe taksave në vend.

6.3. Kompensimi financiar do të përllogaritet në vlerën prej 70% të pagës bazë në vlerën bruto sipas kontratës së punës dhe do të realizohet në baza mujore.

6.4. Punëtorët që janë përfitues të pensionimit të parakohshëm nuk gjëzojnë të drejtën e shtesave të rregullta si punëtorët aktivë, përfshirë:

- a) Pagesat shtesë (solidare, festive, etj.);
- b) Shtesa për shujta;
- c) Kompensimi për udhëtim;
- d) Bonuset e ndryshme (përformancë)
- e) Ndryshime të vlerës së poenit që përcakton pagat e ndërmarrjes;
- f) Përvoja e fituar në punes.

6.5 Punonjësi të cilit i është aprovuar me vendim nga punëdhënësi, pensioni i parakohshëm obligohet që të paraqitet në Zyrën e Burimeve Njerëzore çdo gjashtë (6) muaj, ku do të nënshkruaj listën e paraqitjes e cila listë përcillet në Departament të Financave.

6.5.1 Në rast të mosveprimit sipas prg. 6.5 të këtij neni punëdhënësi nuk do të paguaj kompensimin financiar të përshkruar në prg. 6.2 dhe 6.4 të këtij neni.

Neni 7

Vlerësimi i gjendjes financiare

7.1. Ndërmarrja paraprakisht vlerëson gjendjen financiare dhe barrën që do të shkaktonte pensionimi i parakohshëm i punëtorëve të saj. Mbi këtë bazë, vlerësimi do të bëhet çdo vit, dhe numri i personave që do të lejohen të përfitojnë nga pensionimi i parakohshëm do të përcaktohet pas analizave lidhur me gjendjen financiare dhe organizative të Ndërmarrjes.

Neni 8

Përbajtja e vendimit për pensionim të parakohshëm

8.1. Cilido qoftë vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv, ai duhet të jetë formal dhe të përbajë të gjitha elementet e përcaktuara nga dispozitat ligjore për vendime administrative, me përbajtje të plotë dhe të argumentuar.

8.2 Pavarësisht nga vendimi i punëdhënësit për pensionim të parakohshëm të punonjësit, në rastet kur punonjësi arrin moshën e pensionimit sipas Ligjit të Punës, punëdhënësi do të përgatit vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore, ku edhe do të zbatohet Ligji i punës dhe të gjitha aktet e brendshme të punëdhënësit.

**Neni 9
Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i Drejtoreve.

Datë: 30.06.2025



Bajram MUSTAFA
Kryesues i Bordit të Drejtoreve
të NPH "Ibër Lepenc" Sh.A